

## KUSHTET DHE AFATET

### GARANCI PESË-VJEÇARE SAMSUNG

1. Kjo garanci pesë-vjeçare ofrohet nga Samsung Electronics Austria GmbH, Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, dhe është e vlefshme për pajisjet e blera në periudhën nga 22.11.2019 deri 15.01.2020, vetëm për televizorët, të renditur në faqen e mëposhtme të internetit:  
[www.samsung.com/al/offer/5yw-tv/](http://www.samsung.com/al/offer/5yw-tv/)
2. *\*Termi "të rinj" përfshin gjithashtu pajisjet e papërdorura të ekspozimit dhe pajisjeve në shitje.* Për të ushtruar të drejtën e garancisë pesë-vjeçare, të gjitha detajet rreth pajisjes duhet të regjistrohen online në faqen e internetit: [www.samsung.com/al/offer/5yw-tv/](http://www.samsung.com/al/offer/5yw-tv/) duke ndjekur udhëzimet e dhëna në këtë faqe.
3. Një pajisje për të cilën kërkohet garancia pesë-vjeçare duhet të regjistrohet online (siç tregohet më sipër në pikën 2) jo më vonë se 30 ditë nga data kur është lëshuar fatura e blerjes.
4. Pas regjistrimit, aplikanti do të marrë një email dhe një Letër Garancie për garancinë pesë vjeçare me numrin e serisë së pajisjes së regjistruar.
5. Letra e Garancisë për garancinë pesë-vjeçare duhet të ruhet gjatë gjithë periudhës së garancisë.
6. Garancia pesë-vjeçare nuk mund të transferohet te asnjë pajisje tjetër Samsung, përveç asaj të regjistruar online.
7. Kjo ofertë është e vlefshme vetëm për përdoruesit e fundëm(individë), dhe jo për kompani ose organizata për qëllime rishitjesh ose përdorimi tregtar.
8. Duke e regjistruar pajisjen për garancinë pesë-vjeçare në mënyrën e lartpërmendur, përdoruesit janë dakord me këto Kushte dhe Afate.